



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI**

Nr. 799/3 Prot.

Tiranë, më 12 . 06 . 2026

V E N D I M

Nr. 166, datë 12 . 06 . 2026

Mbështetur në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën me nr. 105, datë 23.04.2026, të E. M, ku pretendohet diskriminim për shkak të “gjinisë” nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues

Subjekti ankues, E. M, në ankesën pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), pretendon se është diskriminuar nga ana e punëdhënësit të saj, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (në vijim referuar me akronimin DPD).

Ankuesja është e punësuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, në Degën e Doganës Durrës, në pozicionin e specialistes juriste, që prej dhjetorit të vitit 2016. Me Urdhrin nr. 21844 prot., datë 22.10.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të DPD-së, është transferuar përkohësisht në detyrë, nga specialiste juriste në Zyrën e Adminsitratës pranë Degës së Doganës Durrës, me detyrë Përgjegjëse Sektori/Sektori i Operacioneve Doganore të po kësaj Dege.

¹ Në vijim do t’i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD ose si Komisioneri.

Më datë 23.03.2026, në Degën e Doganës Durrës është emëruar titullari i ri, D. B. Më datë 31.03.2026, është njohur nëpërmjet postës elektronike me urdhrin e rikthimit të saj në detyrën e mëparshme, si specialiste juriste. Në pozicionin që ajo mbante është emëruar A. S, i cili mbante më parë detyrën e specialistit në Sektorin e Kontrollit të Tarifës, Origjinës dhe Vlerës në Drejtorinë e Paszhdoganimit, pranë DPD-së.

Ankuesja pretendon se është trajtuar në mënyrë të pabarabartë krahasuar me kolegun tjetër burrë, A. S, i cili është emëruar në vend të saj. Këtë trajtim të pabarabartë ankuesja e lidh me gjininë e saj, dhe në këtë kontekst ka pretenduar se DPD e ka diskriminuar atë duke e vënë në pozita të pafavorshme krahasuar me kolegun burrë, pikërisht për shkak të gjinisë.

Në përfundim, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit nga ana e DPD, si dhe marrjen e masave për ndreqjen e pasojave të shkaktuara.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”*.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Pas analizimit paraprak të ankesës më sipër, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Me shkresën nr. 799/1, datë 30.04.2026, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar informacion dhe dokumentacion shkesor nga DPD, përse i takon pretendimeve të subjektit ankues.

2. Me datë 01.06.2026, KMD-së, i është komunikuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, kërkesë-padia e depozituar nga pala paditëse, E. M dhe palë të paditur, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (DPD). Komisioneri është ftuar nga Gjykata në cilësinë e personit të tretë, për paraqitjen e prapësimeve me shkrim.

Gjatë shqyrtimit paraprak që Komisioneri i ka bërë parashtrimeve dhe dokumentacionit të depozituar deri në këtë fazë të hetimit, rezulton se:

Në objekt dhe në parashtrimet e kërkesë-padisë së ankueses drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (në vijim Gjykatës), pretendimi i ngritur nga subjekti ankues për diskriminim në marrëdhëniet e punës, për shkakun e pretenduar, është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor.

Theksojmë se, të njëjtat fakte dhe rrethana janë paraqitur edhe përpara Komisionerit. Po ashtu i njëjti shkak i elaboruar që bëhet prezent në kërkesë-padinë e paraqitur para Gjykatës, është pretenduar dhe tek Komisioneri. Komisioneri konstaton se, në objekt të kërkesë-padisë drejtuar Gjykatës, ankuesja ndër të tjera, kërkon:

- Shfuqizimin e Vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave me nr. 6190 prot., datë 31.03.2026 “Për rikthimin në detyrë”;
- Rikthimin në pozicionin e mëparshëm;
- Konstatimin e diskriminimit gjinor dhe ndërprerje karriere pa bazë.

Në kërkesë-padinë e depozituar në Gjykatë, konstatohet gjithashtu, se në bazën ligjore të cituar prej ankueses, referohet legjislacioni që garanton mbrojtjen e punonjësit nga diskriminimi në marrëdhëniet e punësimit. Kështu, ankuesja citon: Nenin 14 dhe protokollin 12, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; Konventën mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave; Ligjin nr. 10221, datë 04.02.2017 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore”, të ndryshuar si dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së mbi trajtimin e barabartë në marrëdhëniet e punës.

Neni 33, pika 7/4, e ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikon se: *“Kur Komisioneri vihet në dijeni se ankuesi ka paraqitur kërkesë padi në gjykatë me objekt konstatim diskriminimi, ndërkohë që ka paraqitur të njëjtën ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe çështja është në shqyrtim e sipër, Komisioneri merr vendim për pushimin e çështjes.”*

Në këtë kontekst, në kushtet që kjo çështje është duke u gjykuar nga Gjykata, bazuar në sa më sipër, si dhe në paragrafin 3, të nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se: *“...Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata...”*, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk mund të shprehet,

lidhur me ankesën me nr. 105 Regj., datë 23.04.2026, të E. M, dhe deklaroi pushimin e shqyrtimit të saj³.

Bazuar në nenin 36, pika 4, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: “Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në rastin kur Gjykata e kërkon atë, përgatit dhe paraqet mendimin me shkrim, lidhur me çështjen sa më sipër.

Në rastin në fjalë, mendimi me shkrim i Komisionerit është kërkuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe ai do të depozitohet brenda afatit caktuar prej saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 36 të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe referuar nenit 32, pika 1, shkronja a), nenit 33, pika 7/4, dhe nenit 36/4, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Pushimin e shqyrtimit të ankesës nr. 105 Regj., datë 23.04.2026, të paraqitur nga subjekti ankues, E. M, për shkak se çështja është duke u gjykuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Genta Tafa (BUNGO)

³ Për analogji shih vendimet me: nr. 13, datë 28.01.2021; nr. 27, datë 16.02.2021; nr. 77, datë 07.05.2021; nr. 230, datë 25.11.2021; nr. 253, datë 28.12.2021; nr. 77, datë 21.04.2022; nr. 108, datë 20.06.2023; nr. 145, datë 26.07.2023; nr. 89, datë 03.04.2024; nr. 25, datë 30.01.2025; nr. 269, datë 26.11.2025, nr. 20, datë 02.02.2026, nr. 44, datë 26.02.2026, të Komisionerit.